



**ANALIZË E SHKURTËR**

**NR. 1/14 – Prill2014**

# **HETIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË: (MOS) BASHKËPUNIMI NË MES TË POLICISË DHE PROKURORISË**

Ky projekt është i përkrahur nga: Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa dhe Lulzim Peci

Hulumtimi i mbështetur nga: Kastriot Jahaj dhe Violeta Haxholli

Të drejtat autoriale © 2014 nga KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim ri-shfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) or +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rruga "Rexhep Mala", Nr 5A

10 000 Prishtina, Kosovë

Telefon dhe fax: +381 38 227 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## Përmbajtje

I.	Hyrje .....	4
II.	Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për bashkëpunim .....	5
a)	Probleme për efikasitet: kapacitetet institucionale dhe bashkëpunimi .....	7
III.	(Pa)varësia politike e Policisë dhe Prokurorisë në luftë kundër korrupsionit.....	10
IV.	Përfundime dhe Rekomandime.....	12

## I. Hyrje

Institucionet e Kosovës kanë adresuar si një çështje me prioritet kërkesat e BE-së për Udhërrëfyesin e Liberalizimit të Vizave për Kosovën dhe Studimin e Fizibilitetit për Kosovën. BE-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të adresojë rreth 150 kritere në mënyrë që Kosova të avancojë në proceset e saj integruese dhe të udhëtimit të lirë në BE. Prandaj, Qeveria e Kosovës është duke u përpjekur për të siguruar prova të rezultateve në luftën e saj kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe zhvillimin e një mekanizmi përcjellës për të dëshmuar shkallën e suksesshme të ndjekjeve penale dhe dënimeve të korrupsionit. Trajtimi i korrupsionit veçanërisht në nivelin e zyrtarëve të profilin të lartë, duke përfshirë kërkesa të tilla si koordinim më të mirë mes organeve të zbatimit të ligjit dhe hetimeve të paanshme kundër korrupsionit, duke siguruar gjithashtu statistika të besueshme për korrupsion janë kërkesa të nevojshme për Kosovën që të avancojë në rrugën e saj për në BE.<sup>1</sup>

Institucionet e Kosovës kanë qenë efikase në propozim të legjislacionit të ri, hartimin e politikave dhe strategjive të reja megjithatë janë treguar të dobëta në realizimin efikas dhe të paanshëm të kërkesave të tilla. Kjo analizë e shkurtër analizon bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe prokurorisë dhe iniciativat e saj të fundit duke shikuar nëse ky bashkëpunim dhe iniciativë ka qenë në përputhje me kërkesat e caktuara.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, kënaqshmëria publike me punën e Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit ka qenë në rënie. Ndërsa Policia e Kosovës vazhdimisht gëzon besimin më të lartë publik në 6 vitet e fundit (80 % shtator 2008 në 75,1 % prill 2013), Prokuroria e shtetit gëzon besim më të ulët (22,7 % në maj 2008 në 17,7 % prill 2013). Një mospërputhje e tillë e besimit të publikut është reflektuar edhe në përpjekjet për bashkëpunim efikas ndër-institucional, sidomos në fushën e luftimit kundër korrupsionit.

Kuadri ligjor për bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë në hetimin e korrupsionit është në masë të madhe i përcaktuar dhe ai është detalisht i specifikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës dhe nga Ligji për Policinë. Megjithatë, problemet ndodhin gjatë bashkëpunimit praktik që shkaktohet nga mungesa e bazës së duhur të të dhënave dhe menaxhimit të dosjeve të rasteve.

Ka pasur progres në paraqitje të rasteve kundër korrupsionit, por prokurorët vendorë janë marrë kryesisht me raste të profilin të ulët. Përveç kësaj, iniciimi i hetimeve të parapara me ligj ka qenë minimal nga ana e prokurorëve vendor (0,52 %), ndërkohë që Policia e Kosovës ka iniciuar pothuajse 77 % të rasteve. Deri tani, rastet e profilin të lartë dhe rastet e rrezikshme janë hetuar dhe ndjekur penalisht nga EULEX-i. Pamundësia e prokurorëve vendorë që të merren me raste të profilin të lartë mbetet një shqetësim serioz për forcimin e performancës së institucioneve të sundimit të ligjit.

Hetimet e korrupsionit të rasteve të profilin të lartë nga ana e prokurorëve vendorë dhe Policisë së Kosovës janë peng i ndërhyrjeve politike dhe mungesës të pavarësisë së këtyre institucioneve, e cila në fakt është pranuar gjerësisht nga zyrtarët vendor, prania diplomatike në Kosovë dhe raportet vjetore të Komisionit të Bashkimit Evropian (BE-së). Mungesa e efikasitetit dhe pavarësisë së institucioneve të sundimit të ligjit për t'u marrë me korrupsionin e bën zgjatjen e mandatit të EULEX-it të nevojshme dhe të pashmangshme.

---

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit 2013. Fq10, 12 dhe 13.

Në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

## II. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për bashkëpunim

Kodi i Procedurës Penale (Nr. 04/L-123 ) dhe Ligji për Policinë ( Nr. 03/L-035 ) janë ligjet kryesore që parashikojnë bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe shërbimeve prokuroriale në Kosovë. Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) të Kosovës (2013), roli kryesor në hetimin e krimeve është i paraparë për shërbimet prokuroriale mbështetur nga policia për kryerjen e detyrës së hetimit. Prokurori i Shtetit varet nga policia, por jo ekskluzivisht, siç thuhet në KPP "një prokuror i shtetit mund të iniciojë një procedurë penale pas marrjes së informacionit nga policia".<sup>2</sup> Megjithatë, në procesin e hetimit të dy organet do të punojnë së bashku në hapat e parë.<sup>3</sup> Prokuroria drejton dhe mbikëqyr punën e policisë dhe organeve të tjera që kryejnë hetimet penale, pasi që një masë e tillë është e autorizuar ose iniciohet përdorur ka edhe të drejtë për qasje në të gjitha informatat relevante hetimore të cilat policia i posedon.<sup>4</sup>

Për më tepër, siç thuhet në Kod policia ka për detyrë të sigurojë një raport prokurorit shtetëror kompetent sipas afatit të paraparë prej njëzet e katër (24) orëve sapo që ata të marrin një dyshim të arsyeshëm se një veprë penale është kryer.<sup>5</sup> Bazuar në këtë raport prokuroria vendos për të filluar ose jo procedurën penale.<sup>6</sup> Në rast se prokuroria vendosë të tërhiqet nga një procedurë penale një vendim duhet të hartohet duke deklaruar në mënyrë të qartë arsyet për ndërprerjen e procedurës penale me një vendim me shkrim brenda tridhjetë (30) ditësh.<sup>7</sup> Policia luan një rol të madh në ndjekjen e veprave penale, kur është fjala për mbledhjen e informatave të nevojshme për fillimin e hetimit dhe policia është e detyruar të ndjek kërkesën e prokurorisë.<sup>8</sup> Në qoftë se aktakuza nuk është ngritur dy vjet pas fillimit të hetimit, atëherë konsiderohet se hetimi përfundon automatikisht.<sup>9</sup>

Vija e përgjegjshmërisë është nga policia në prokurori me detyrën e policisë të raporton menjëherë prokurorit shtetëror mbi masat e ndërmarra në bazë të udhëzimeve të tyre. Në rast se ata nuk do të jenë në gjendje të kryejnë ndonjë nga masat e parashikuara hetimore atëherë ata do të raportojnë menjëherë prokurorit shtetëror arsyet për paaftësinë e tyre për të ndërmarrë masa të tilla.<sup>10</sup> Kodi parashikon bashkëpunimin në mes prokurorit të shtetit dhe policisë edhe kur është fjala për të ashtuquajturën Sekuestrimin e Përkohshëm, ku

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 6, Fillimi i Procedurës Penale, paragrafi 3.

Në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 69, Hetimet nga Policia, paragrafi 2.

<sup>4</sup> Ibid, paragrafi 3 dhe 4.

<sup>5</sup> Në Kod shkruan "...kallëzimi penal ipolicisë dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës." Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 81, Kallëzimi penal i Policisë, paragrafi 2 dhe 3.

<sup>6</sup> Nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 70 dhe 81 i Kodit paragrafi 4.

<sup>7</sup> Arsyet e shënuara tek Kodi i Procedurës Penale të Kosovës janë: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer veprë penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. I dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është e miratuar nga organi kompetent; ekzistojnë rrethana tjera që të cilat përjashtojnë ndjekjen. (Neni 82, Hedhja e kallëzimit penal, Paragrafi 1).

<sup>8</sup> "Prokurori i shtetit ndërmerr veprime hetimore ose të autorizoj policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave." Neni 104, Aktvendim për fillimin e fazës së hetimit, paragrafi 4 dhe Neni 83, paragrafi 1.

<sup>9</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 159 thotë në Afatet Kohore të Hetimit se "Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuza, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet..

"Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>10</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 83, Informatë Shtesë për Kallëzimin Penal, paragrafi 3.

prokuroria dhe policia ndajnë përgjegjësinë për të ruajtur dhe regjistruar në mënyrë të përshtatshme artikuj të tillë.<sup>11</sup> Për më tepër, prokurori shtetëror mund të autorizojë policinë edhe për të ekzaminuar, analizuar dhe për të kërkuar informacione ose të dhëna në pajisje kompjuterike, pajisje për ruajtje të dhënave elektronike ose pajisje të ngjashme duke përfshirë të dhënat financiare të një të dyshuari që janë marrë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet një urdhri të gjykatës ose me pëlqim.<sup>12</sup> Për më tepër, sipas Ligjit të Kosovës për Policinë, ka dispozita të tjera të hollësishme të bashkëpunimit të përshkruara në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës që mbulojnë marrëdhëniet në mes të Policisë, Prokurorëve Publik dhe Gjykatës.<sup>13</sup>

Shërbimet e prokurorisë përmes KPK-së kanë ndërmarr në vitet e fundit, për shkak të kërkesave të BE-së në luftën kundër korrupsionit, një sërë nismash për të rritur efikasitetin dhe për të përmirësuar shkallën e suksesit në luftë kundër korrupsionit. Në vitin 2012, KPK-ja ka intensifikuar përpjekjet e saj duke hartuar dy Memorandume Mirëkuptimi për të adresuar çështjen e kërcënimeve kundër prokurorëve dhe për të intensifikuar bashkëpunimin e agjencive të zbatimit të ligjit në luftë kundër korrupsionit.<sup>14</sup> Në të njëjtin vit edhe KPK-ja miratoi "Planin Strategjik për Bashkëpunim Ndër-Institucional 2013-2015 të Prokurorit të Shtetit të Kosovës", duke e bërë KPK-në agjenci kryesuese në standardizimin e hetimeve penale për korrupsion dhe gjithashtu duke parashikuar memorandume të tjera të mirëkuptimit që duhet të nënshkruhen me agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit për të rritur efektivitetin e punës kundër korrupsionit.<sup>15</sup> MM të tilla ende duhet të hartohen. Plani gjithashtu parashikon raportimin e përbashkët të këtyre agjencive lidhur me rezultatet në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.<sup>16</sup>

Përveç kësaj, në vitin 2013 Prokurori i Shtetit ka hartuar "Planin e Veprimit për Rritjen e Efektivitetit të Sistemit të Prokurorisë në luftë kundër Korrupsionit", duke bërë Kryeprokurorët në Zyra të Prokurorisë Themelore lidhje institucionale udhëheqëse në luftë kundër rasteve të korrupsionit. Plani është parashikuar të vlerësohet nga ana e KPK-së në Qershor të vitit 2014.<sup>17</sup> Plani i Veprimit përpiqet të tejkalojë lidhjet e dobëta të bashkëpunimit në mes të organeve të sundimit të ligjit duke synuar në veçanti bashkëpunimin mes Policisë dhe Prokurorisë. Më tej, Plani i Veprimit kërkon nga Kryeprokurorët e Zyrave të Prokurorisë Themelore në Kosovë për të diskutuar me Policinë e Kosovës dhe me agjencitë tjera për rastet në fazën paraprake të

---

<sup>11</sup> Sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontejnerë përkatës apo në qese transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar ipolicisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave. Shih Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 112, Sekuestrimi i Përkohshëm, paragrafi 2, 4,5 dhe 7.

<sup>12</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 147 dhe 148, Analizë Kompjuterike dhe Analizë Financiare, paragrafi 2.

<sup>13</sup> Republika e Kosovës Ligji Nr. 04/L-076 mbi Policinë, Neni 6, Marrëdhënia mes Policisë, Prokurorisë Publike dhe Gjykatës, paragrafi 1, faqe 4, [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Law\\_on\\_Police.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Law_on_Police.pdf)

<sup>14</sup> Shih p.sh Memorandum i Mirëkuptimit nënshkruar në mes KPK, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencioni kundër Korrupsionit dhe Agjencioni Kosovar i Inteligjencës për të emëruar Koordinatorin Nacional për të luftuar Krimet Ekonomike ([http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014 - Memorandum Bashkepunimi fin.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014_-_Memorandum_Bashkepunimi_fin.pdf)).

Gjithashtu shiko MM në mes KPK dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi Bashkëpunimin në fushë të sigurisë individuale të prokurorëve në rastet e kërcënimit kundër prokurorëve ([http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.932.2013-Marreveshje\\_Mirekuptimi\\_mes\\_KPK-se\\_dhe\\_Policise\\_se\\_Kosoves-Bashkepunimi\\_në\\_fushën\\_e\\_sigurisë\\_individuele\\_të\\_prokurorëve\\_në\\_rastet\\_e\\_kërcënimeve\\_ndaj\\_tyre.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.932.2013-Marreveshje_Mirekuptimi_mes_KPK-se_dhe_Policise_se_Kosoves-Bashkepunimi_në_fushën_e_sigurisë_individuele_të_prokurorëve_në_rastet_e_kërcënimeve_ndaj_tyre.pdf))

<sup>15</sup> Shiko pjesën 4A, 4E, 4H të Planit Strategjik i Bashkëpunimit Ndër-Institucional 2013-2015, miratuar në Nëntor 2012. Në [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Strategic\\_Plan\\_for\\_Inter-Institutional\\_Cooperation\\_2013-2015\\_1.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Strategic_Plan_for_Inter-Institutional_Cooperation_2013-2015_1.pdf)

<sup>16</sup> Plani Strategjik i Bashkëpunimit Ndër-Institucional 2013-2015, Pjesa 4H, Koordinimi i komunikimit ndër-institucional me Media dhe Publik, paragrafi 1, faqe 8, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Strategic\\_Plan\\_for\\_Inter-Institutional\\_Cooperation\\_2013-2015\\_1.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Strategic_Plan_for_Inter-Institutional_Cooperation_2013-2015_1.pdf)

<sup>17</sup> Neni 8, Ibid.

hetimeve ku mund të paraqitet nevoja për caktimin më të hershëm të Prokurorit para se kallëzimi penal të jetë ngritur.<sup>18</sup> Dispozitat e shënuara në bazë të këtij Plani të Veprimit parashikojnë në më shumë detaje zbatimin e masave të cilat janë të parashikuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, por kërkojnë rritjen e nivelit të zbatimit dhe llogaridhënies së shërbimeve prokuroriale përmes monitorimit të rregullt të KPK-së. Pjesa e mëposhtme shqyrton aspektet ligjore të këtij bashkëpunimi dhe identifikon më tej problemet në zbatimin e tyre.

#### **a) Probleme për efikasitet: kapacitetet institucionale dhe bashkëpunimi**

Organi kryesor i Policisë së Kosovës me mandat për të luftuar korrupsionin në Kosovë është Drejtoria për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike që ndodhet në Prishtinë dhe ka 6 njësi rajonale që raportojnë Drejtorisë. Drejtoria ka arritur gjatë dy viteve të fundit të rrit numrin e zyrtarëve të policisë në 130, dhe 96 oficerë janë direkt të përfshirë në hetime.<sup>19</sup>

Drejtorja gjithashtu kryen vlerësime të performancës dhe është duke punuar në zhvillimin e Procedurave Standarde të Veprimit për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë, një praktikë që nuk është aplikuar në Prokurorinë e Shtetit deri tek miratimi i "Planit të Veprimit për Rritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në luftë kundër korrupsionit." Si rezultat i kësaj, shumica e rasteve të korrupsionit të iniciuara në Kosovë janë kryer nga Policia e Kosovës. Shumë më vonë se Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës KPK-ja kohës së fundit ka iniciuar një sistem më dinamik për të vlerësuar punën e prokurorëve. Është krijuar një bazë të dhënash që regjistron veprimet e prokurorëve duke angazhuar gjithashtu edhe një komision të brendshëm të përbërë nga prokurorë të lartë që shikojnë punën e prokurorëve të rinj. Në këtë vlerësim të performancës në mes të kritereve tjerë vetë-iniciues për iniciimin e rasteve është përfshirë një normë mbi rastet që janë zgjidhur.<sup>20</sup> Në vitin 2013 KPK-ja ka vlerësuar se prokurorët kishin tejkaluar përqindjen e rasteve deri në 200% por pa vlerësuar cilësinë e rasteve që do të thotë në çfarë mase rastet janë zbatuar me sukses.

Për sa i përket parregullsive në iniciimin e procedurës penale, sipas udhëheqësit të Drejtorisë për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës, ka pasur raste kur prokurorët pas marrjes së informacionit nga mediat verbalisht kanë udhëzuar Drejtorinë për fillimin e hetimeve.<sup>21</sup> Në përputhje me Kodin e Procedurës Penale<sup>22</sup> të Kosovës policia duhet të njoftohet nga prokuroria për fillimin e hetimeve me shkrim si dhe për tërheqjen e prokurorëve nga procedura penale. Megjithatë, policia deklaroi që shpesh vetë ata kërkojnë shpjegime nga prokuroria ku arsyet e cekura nga prokurorët janë jo të mjaftueshme, siç kërkohet nga ligji. Në përgjithësi, policia konfirmon se bashkëpunimi është më i mirë kur punojnë me Kryeprokurorët e Zyrës së Prokurorisë Themelore.<sup>23</sup>

Për më tepër, administrata e Prokurorisë së Shtetit shpesh ka regjistruar të njëjtin rast disa herë. Sipas udhëheqësit të Drejtorisë për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës kjo ka ndodhur kur është hapur një rast dhe dëshmitë shtesë të dorëzuara nga policia për të njëjtin rast janë

---

<sup>18</sup> Plani i Veprimit mbi rritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në luftë kundër korrupsionit, Neni 7, Bashkëpunimi me Policinë, Agjencionit Kundër-Korrupsion dhe dorëzuesit tjerë të kallëzimeve penale, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Action\\_Plan\\_-\\_Corruption.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Action_Plan_-_Corruption.pdf)

<sup>19</sup> Intervistë me Drejtorin e Drejtoratit kundër Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, Z. Emin Beqiri, prill 2014.

<sup>20</sup> Ibid

<sup>21</sup> Ibid.

<sup>22</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës Neni 82, Hudhja poshtëkallëzimit penal të policisë, Paragrafi 1

<sup>23</sup> Supra shënim në 19.

parashtruar nga administrata e Prokurorit të Shtetit si lëndë e re.<sup>24</sup> Kjo ka çuar në rritje të madhe të rasteve të raportuara dhe ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe përmbylljen e rasteve.

Si rezultat i presionit për të luftuar korrupsionin dhe kërkesat e BE-së për zhvillimin e një mekanizmi përcjellës, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka bërë disa përpjekje për të tejkaluar shumëzimin dhe keqmenaxhimin e rasteve, duke krijuar bazën e të dhënave të njohur si Mekanizmi Përcjellës. Baza e të dhënave është bërë funksionale me vështirësi dhe u nis në nëntor 2013. Pritet që baza e të dhënave të bëhet plotësisht funksionale dhe të jep rezultate të sakta deri në qershor 2014. Ajo ka kodifikuar<sup>25</sup> edhe veprat penale kundër korrupsionit pasi kjo përbente një problem në të kaluarën me menaxhimin e lëndëve të korrupsionit dhe rasteve tjera kriminale, të cilat nuk janë klasifikuar sipas kategorive përkatëse.

Të dhënat dhe menaxhimi i dosjes së lëndëve është identifikuar si një nga çështjet kyçe për përmirësimin e performancës së institucioneve të sundimit të ligjit nga ana e Raportit të Progresit të Komisionit të BE-së të vitit 2013 dhe kjo ka qenë një temë që përsëritet për disa vjet. Megjithatë, disa gjysmë - hapa janë ndërmarrë në adresimin e kësaj çështje nga këto institucione në vitin 2013 dhe 2014. Lidhur me këtë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në mars 2014 lëshoi një raport për të harmonizuar statistikën për vitin 2013 të përcjellura nga prokuroria dhe gjykatat. Raporti "Harmonizimi i Statistikave të Mekanizmit Përcjellës Ndër-institucional mbi karakteristikën e veprave penale duke përfshirë rastet e korrupsionit, është hartuar bazuar në të dhënat nga sistemi i bazës së të dhënave të zhvilluar nga KPK-ja.<sup>26</sup> Baza e të dhënave është një sistem i thjeshtë qasje në bazë të të dhënave që gjurmon rastet duke përfshirë korrupsionin, standardizimin e veprave të ndryshme penale, në përputhje me Kodin e ri të Procedurës Penale dhe gjurmon këto raste nga iniciimi, aktakuza, mbështetja ose refuzimi i aktakuzave nga gjykatat dhe ofron për gjykim detaje nga gjykatat. Edhe pse raporti është përpjekur për të standardizuar shumëzimin e rasteve të raportuara, baza e të dhënave nuk përfshin ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe dënimin e rasteve, që është në kundërshtim me kërkesat e BE-së për përcjellje të shkallës së suksesit të rasteve të korrupsionit të hetuara dhe dënuar në Kosovë. Baza e të dhënave me qasje ka mbështetur procesin e mbledhjes së të dhënave megjithatë nuk e zgjidh problemin e mbledhjes së të dhënave të rregullt dhe transparente dhe menaxhimin e dosjes së lëndëve në matjen e efikasitetit dhe shkallës së suksesit të sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

Një qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e problemit të të dhënave dhe menaxhimit të dosjes së rasteve është ndërmarrë nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili do të implementojë një sistem të avancuar të quajtur Teknologjia e Komunikimit të Informatave sistem bazë për Menaxhimin e Rasteve dhe Sistem të Informatave (CMIS) që synon Gjyqësorin Kosovar dhe shërbimet e Prokurorisë të ashtu-quajtur "Projekti për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Rasteve nga Gjykatat dhe të Prokuroria."<sup>27</sup> Ministria norvegjeze do të financojë 6.660.000 euro për projektin me 1.500,000 euro fondet përputhëse nga KGJK-ja

<sup>24</sup>Interviste e KIPRED me Drejtorin e Drejtoratit kundër Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, Z.Emin Beqiri, prill 2014.

<sup>25</sup>Kodi për rastet e Korrupsionit të përdorur është KORR/emri i personit të akuzuar.

<sup>26</sup>[http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.235.2014-Raporti\\_vjetor\\_2013\\_i\\_Harmonizimit\\_te\\_Statistikave\\_-\\_FINAL.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.235.2014-Raporti_vjetor_2013_i_Harmonizimit_te_Statistikave_-_FINAL.pdf)

<sup>27</sup> Projekti është në përputhje me Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në ICT 2012-2017. Në [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Kosovo-ICT-strategy\\_389023.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Kosovo-ICT-strategy_389023.pdf) dhe Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me vendosjen në përdorim të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (ICT) në Gjykata dhe Zyre të Prokurorisë [http://www.psh-ks.net/repository/docs/MOU\\_KJC\\_and\\_KPC ICT USE\\_2\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/MOU_KJC_and_KPC ICT USE_2_.pdf)



dhe KPK-ja. Projekti është në fazën e parë të implementimit megjithatë ambasadori norvegjez në Kosovë z. Ian Braathu e ka bërë të qartë për autoritetet e Kosovës që në rast të mungesës së përparimit në fazën aktuale (të parë), qeveria norvegjeze do të rishqyrtojë vazhdimin e mbështetjes së këtij projekti.<sup>28</sup> KGJK dhe KPK nuk e kanë luksin për të dështuar në implementimin e këtij projekti, për shkak të pasojave që një dështim i tillë mund të shkaktojë administrimit të përgjithshëm të sundimit të ligjit në Kosovë dhe progresin e saj drejt liberalizimit të vizave dhe procesin e integritimit në BE.

Për shkak të kërkesave të Komisionit të BE-së në Udhërrëfyesin e Liberalizimit të Vizave dhe MSA, Këshilli Prokurorial i Kosovës udhëheq në rritjen e efektivitetit të aktiviteteve kundër korrupsionit duke hartuar Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit. Kërkesat e reja të kodit të procedurës penale balançojnë rolin e policisë dhe prokurorisë në hetime dhe akuza në raste penale. Kodi lejon fleksibilitet për policinë për të hetuar veprimtari kriminale por gjithashtu parashihet rol proaktiv për prokurorët të kryejnë hetime duke u përqendruar në korrupsion apo krim të organizuar edhe kur nuk dihen emrat e të pandehurve.<sup>29</sup>

Përveç kësaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës, EULEX-i dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) kanë nxjerrë një udhëzim të përbashkët për të definuar të gjitha rastet e korrupsionit duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Ata kanë emëruar 45 prokurorë që duhet ta bëjnë prioritet luftën kundër korrupsionit dhe hetimet e krimeve ekonomike. Si rezultat, ka pasur një rritje në rastet e korrupsionit të hetuara dhe padi. Por, realiteti i marrjes së rolit udhëheqës institucional në hapjen e rasteve të korrupsionit nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe Planin e Veprimit dhe Strategjisë të KPK-së e cila parashikon një rol udhëheqës për prokurorët. Në vitin 2013, KPK-ja ka raportuar se në mesin e rasteve të gjurmuar rastet e korrupsionit kanë dominuar me 53.60 % pra 778 raste, pasuar nga 22.60 % të rasteve të narkotikëve/drogës, nga numri i përgjithshëm i 1585 rasteve të paditur. Por, rastet e iniciuara nga prokurorët me iniciativën e tyre janë minimal - vetëm 5 raste ose 0.52 % në krahasim me Policinë e Kosovës që e ka iniciuar 76.99 % të 746 rasteve në total.

KPK-ja konsideron mungesën e iniciativës nga ana e prokurorëve si një nga problemet kryesore të dështimit në luftën efektive kundër korrupsionit.<sup>30</sup> Shembulli i mungesës së prokurorëve që kanë aplikuar për të qenë pjesë në PSRK pasi që u hap shpallja për punë në PSRK në vitin 2013. Nuk ka pasur prokurorë vendor që kanë aplikuar të punojnë me PSRK-në. Në përputhje me KPK-në kjo ka treguar një mungesë vullneti, por edhe mungesë guximi nga prokurorët që të jenë pjesë e një strukture për të luftuar korrupsionin dhe rastet e krimit të organizuar.<sup>31</sup>

Një afat jo-ligjor dhe jo real që mund të dëmtojë cilësinë e procedurës penale nga Prokuroria e Shtetit ka qenë e përcaktuar nga Plani i Veprimit i KPK-së. Sipas Planit, rastet e raportuara deri në nëntor 2013 nga agjencitë e ndryshme duke përfshirë këtu edhe raportet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe procedurat penale të

---

<sup>28</sup>“Norvegjia ia kushtëzoi milionat Kosovës: Ambasadori Norvegjez kërkon gjyqësor efikas,” fq.1 dhe 5 gazeta Kosova Sot, 8 prill 2014.

<sup>29</sup> Smibert, John, “Udhëzuesi i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (2013) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës” Zyra Tej-oqeanike e Zhvillimit Prokurorial dhe Trajnimeve, Ambasada Amerikane Prishtinë. Në [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Udhzuesi-dhe-kodi-i-procedures\\_anglisht\\_225215.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Udhzuesi-dhe-kodi-i-procedures_anglisht_225215.pdf)

<sup>30</sup>Intervistë e KIPRED me Shkelzen Maliqin, Drejtor Gjeneral i Këshillit Prokurorial të Kosovës, janar 2014.

<sup>31</sup> Ibid

paraqitura nga policia duhet të ngritet aktakuza ose të ndërpritet deri në qershor 2014.<sup>32</sup> Drejtori i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka deklaruar se "Prokurorët janë të detyruar ose të ngrisin aktakuzën ose të përfundojnë rastet, pasi që prokurori është i detyruar të japë rezultate."<sup>33</sup> Afati kohor i imponuar përveç që nuk është në përputhje me Kodin Penal të Kosovës, me siguri do të rrisë probabilitetin për trajtimin joprofesional të rasteve nga ana e prokurorëve, krijon hapësirë për keq-menaxhim dhe drejtësi selektive. Për më tepër, kjo e bën Prokurorinë e Shtetit të ndjeshme ndaj ndërhyrjeve politike, pasi që afati i fundit përkon me kohën e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë.

### III. (Pa)varësia politike e Policisë dhe Prokurorisë në luftë kundër korrupsionit

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit të BE-së 2013 për Kosovën<sup>34</sup>, ndërhyrjet politike në punën e gjyqësorit mbeten një shqetësim serioz. Ndërhyrjet politike në sistemin gjyqësor të Kosovës kanë filluar me koalicionin qeveritar mes PDK (Partia Demokratike e Kosovës) dhe LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) në vitin 2008. Në atë kohë, një përfaqësues gjyqësor deklaroi se Kryetarët e gjykatave kryesore dhe pozita të tjera Gjyqësore ishin të ndara në mesin e atëherë partive të koalicionit LDK dhe PDK.<sup>35</sup> Trendi i ndërhyrjes politike filloi të ashpërsohej me qeverinë e re të udhëhequr nga PDK-ja pas zgjedhjeve të vitit 2010. Kryetarët e pozitave kyçe në institucionet e drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Enver Peci), Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit (Ismet Kabashi) dhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese (Enver Hasani) janë nga Mitrovica, ndërsa vetëm Kryetari i Gjykatës Supreme (Fejzullah Hasani) është nga Kamenica. Në shërbimet prokuroriale lidhjet apo besnikëria ndaj partisë në pushtet PDK-së ose ndaj ish strukturës së SHIK-ut citohen shpesh si dikush është " ... shumë i fortë për Mitrovicën ." <sup>36</sup> Po kështu ndërhyrjet politike janë vërejtur në disa emërime të prokurorëve nga rajonet e Mitrovicës, Drenasit, Glogoc dhe Ferizaj, shpesh të referuara si zonat fortesë të PDK-së.<sup>37</sup> Ndërhyrje të ngjashme janë vërejtur në të kaluarën në shkallë presidenciale tek emërimet gjyqësore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ish Kryetarët.<sup>38</sup> Sa i përket kësaj, fakti që Prokuroria e Kosovës ka iniciuar vetëm 5 raste në vitin 2013<sup>39</sup> tregon dobësinë institucionale dhe ndërhyrje të mundshme në sistemin e drejtësisë.

---

<sup>32</sup>Shih Neni 3, paragrafi 1, Neni 4, paragrafi 2 dhe Neni 8, Paragrafi 5 nëpërcaktim të rasteve sipas prioriteteve dhe afateve kohore për Planin e Veprimit, dhe në: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Rritjen\\_e\\_Efikasitetit\\_te\\_Sistemit\\_Prokurorial.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf)

<sup>33</sup>Intervistë e KIPRED me Shkelzen Maliqin, Drejtor Gjeneral i Këshillit Prokurorial të Kosovës, janar 2014.

<sup>34</sup> Këshilli Evropian, Raporti i Progresit 2013, fq 12.

Në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>35</sup>Burim i KIPRED, prokuror i lartë vendor, dhjetor 2013.

<sup>36</sup>Burim i KIPRED, intervistë me zyrtarë të menaxhmentit të nivelit mesatar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, shtator 2013. Shiko informatat në dispozicion online për emërime të prokurorëve, Zyra e Kryetarit, lajmet në arkiv <http://www.president-ks.gov.net/>

<sup>37</sup>Burim i KIPRED, intervistë me zyrtarë të menaxhmentit të nivelit mesatar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, shtator 2013. Shiko informatat në dispozicion online për emërime të prokurorëve, Zyra e Kryetarit, lajmet në arkiv <http://www.president-ks.gov.net/>

<sup>38</sup> Shih "Fuqia e pandashme: Analize e pavarësisë së gjyqësorit në Kosovë" (shtator 2011) KIPRED, në [http://www.kipred.org/advCms/documents/84611\\_Inseparable\\_power\\_ENG\\_final.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/84611_Inseparable_power_ENG_final.pdf)

<sup>39</sup> Shih Raportin Vjetor (2013) për Harmonizim të Statistikave: Mekanizmi Ndër-Institucional për Harmonizim të Statistikave për karakteristikat e veprave penale, Këshilli Prokurorial i Kosovës. At [http://www.psh-ks.net/repository/docs/ANNUAL\\_REPORT\\_\(2013\)\\_ON\\_TRACKING\\_MECHANISM.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/ANNUAL_REPORT_(2013)_ON_TRACKING_MECHANISM.pdf)

Shqetësimet për ndërhyrje politike në institucionet e zbatimit të ligjit janë shprehur publikisht nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe nga të pranishmit diplomatik në Kosovë. Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Bajram Rexhepi ka deklaruar se individët jozyrtarë, deputetë, liderë të profilit të lartë e thërrasin policinë dhe ndërhyjnë në punën e policisë potencialisht si një kthim i një të mire/favori. Megjithatë, ministri pohon se ai ka arritur të zvogëlojë ndërhyrjet e tilla brenda Policisë së Kosovës.<sup>40</sup> Me sa duket ka grupe jo-zyrtare në polici që janë individë apo institucione të cilat synojnë të ndikojnë në aspektin operacional dhe ata po vazhdojnë të ushtrojnë ndikim në Policinë.<sup>41</sup> Në mënyrë të ngjashme Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë Peter Blomeyer, ka shprehur shqetësimin e tij se gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it kanë raportuar presionin e ushtruar mbi gjykatës dhe prokurorët vendorë (Kosovar) nga politikanët apo nga njerëzit e fuqishëm.<sup>42</sup> Ky lloj presioni është raportuar edhe nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Zyrtarët e kësaj agjencie kanë marrë thirrje telefonike, e-mail privat, letra, madje edhe vizita në zyre gjoja për të marrë informacione në lidhje me disa raste nën hetime. Kjo është konsideruar nga Agjencia si presion dhe një tendencë të frikësimit ndaj zyrtarëve dhe punës së tyre dhe ka bërë thirrje që veprimet e tilla të ndalojnë.<sup>43</sup>

Ka të dhëna se edhe Kryeministri - Thaçi dhe anëtarë kyç të Qeverisë ishin të përfshirë në punën hetimore të policisë dhe prokurorisë. Rasti ka ndodhur në qershor të vitit 2008, kur një njeri hyri në shtëpinë e Kryeministrit, ku fillimisht u raportua në media si sulm kundër Kryeministrit. Pavarësisht që rezultatet e hetimeve të policisë treguan se kjo ishte një tentim i dështuar për vjedhje, prokurori mbante rastin si tentim vrasje ndaj kryeministrit Hashim Thaçi. Hetimet treguan se autori nuk kishte armë dhe nuk e dinte se ishte shtëpia e kryeministrit.<sup>44</sup> Si pasojë e këtij rasti, Gjeneral Major Rrahman Sylejmani, i cili ka deklaruar në mënyrë profesionale se ky rast nuk ka të bëjë me vrasje por vjedhje, është shkarkuar më vonë nga funksioni i tij si asistent i Komisarit të Policisë për Shtyllën e Krimit.<sup>45</sup>

Megjithatë, ndërhyrja politike nuk ndikon vetëm hetimet policore por edhe ndryshimin e menaxhimit strukturor. Sipas Z. Behar Selimi, anëtar i Komitetit Parlamentar për Legjislacion dhe ish ushtrues detyre Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ky ndikim nuk vjen nga Ministria e Punëve të Brendshme, por nga individë në politikë apo nga persona që mbajnë pozita publike.<sup>46</sup> Në vitin 2011 është raportuar se Ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi për shkak të dyshimeve se zyrtarë të lartë të policisë janë të lidhur me struktura të ndryshme ilegale të inteligjencës në Kosovë, bëri disa ndryshime në strukturën e Policisë së Kosovës. Megjithatë, pas disa muajve këta oficer të policisë janë kthyer në të njëjtat pozita menaxheriale.<sup>47</sup>

Që nga shpallja e pavarësisë, Policia e Kosovës në bashkëpunim me prokurorët vendorë kanë hetuar disa raste të profilit të lartë të korrupsionit, në të cilat ishte ngritur aktakuza, por nuk u dëshmuar në Gjykata, si rasti i ish-Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Z. Hashim Rexhepi. Paaftësia e inicimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë është një tregues i qartë i ndërhyrjeve politike dhe mungesa e pavarësisë së

---

<sup>40</sup> Shih Bajram Rexhepi intervistën nëtelevizion vendor, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,174633>

<sup>41</sup> Intervista e KIPRED me Këshilltarin e Ministrit të Punëve të Brendshme (Fisnik Rexhepi), 14 janar, 2014.

<sup>42</sup> Shih intervistën e Ambasadorit Peter Blomeyer për gazetën vendore, <http://www.zeri.info/artikulli/25371/politikanet-telefonojne-prokuroret>

<sup>43</sup> "Presion mbi Agjencinë kundër Korrupsionit", Indeksonline, 27 janar, 2014 <http://indiksonline.net/?PageID=2&LajmID=83236>

<sup>44</sup>Burim i KIPRED, Menaxhment i Lartë i Policisë së Kosovës, nëntor 2013.

<sup>45</sup> Ibid.

<sup>46</sup>Intervistë e KIPRED me AP Zt.Behar Selimi, 12 dhjetor, 2013.

<sup>47</sup> Shih raportin e KIPRED "Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e pajustificueshme" fq.14, 2013. Ne: [http://www.kipred.org/advCms/documents/42734\\_Investigating\\_inexplicable\\_wealth\\_ENG.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/42734_Investigating_inexplicable_wealth_ENG.pdf)

sistemit të drejtësisë që dukshëm ekziston vetëm në letër në Kosovë. Këto rezultate shumë të varfra minojnë përparimin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe vazhdueshme nga Raportet e Komisionit të BE-së për përmirësimin e performancës së institucioneve të sundimit të ligjit. Kështu, vazhdimi i mandatit të EULEX-it është i nevojshëm për të siguruar efikasitetin bazë të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë.

#### **IV. Përfundime dhe Rekomandime**

Bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorisë është përmirësuar gjatë vitit të fundit, por mungesa e vet-iniciativave nga prokuroria për të kryer hetime të paanshme dhe efikase mbetet çështje shqetësuese. Shumëfishimi i rasteve të trajtuara nga policia, prokuroria dhe gjykatat vazhdon të shkaktoj probleme me grumbullimin e rasteve dhe në krijimin e një mekanizmi të saktë dhe të besueshëm të përcjelljes/gjurmimit për Kosovën. Për më tepër, menaxhimin e të dhënave dhe rasteve është ende larg prej sigurimit të sistemit të menaxhimit transparent dhe të përgjegjshëm në mënyrë që të shërbejë interesin publik në përmbushjen e kërkesave të BE-së për Kosovën.

Përderisa ka përmirësime të rëndësishme në rritje të kallëzimeve penale në nivelin e përgjithshëm të prokurorisë, rastet e vogla të korrupsionit vazhdojnë të zhvendosin vëmendjen nga nevoja e Kosovës për të hetuar, akuzuar dhe dënuar raste të korrupsionit të profilit të lartë.

Ndërhyrja politike mbetet një shqetësim serioz dhe sfidë për Kosovën për të siguruar dhe promovuar efikasitetin, paanshmërinë dhe drejtësinë e sistemit të drejtësisë, e cila nëse nuk trajtohet menjëherë mund të ketë efekte shkatërruese tek sistemi i dobët i sundimit të ligjit në vend. Sigurimi i korrektesisë së zbatimit të ligjit dhe procedurave penale të prokurorisë duhet të bëhet prioritet kyç i institucioneve politike dhe institucioneve të sundimit të ligjit të Kosovës, për të siguruar drejtësinë penale të drejtë dhe të barabartë dhe mbrojtjen efektive të qytetarëve në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.<sup>48</sup>

Zbatimi i ligjit në mënyrë të paanshme dhe efikase dhe zbatimi i shërbimeve prokuroriale është me rëndësi vitale për administrimin profesional të drejtësisë, pa të cilat progresi i Kosovës drejt integritetit në BE dhe liberalizimi i vizave nuk mund të imagjinohet. Prandaj, hetimet dhe procedurat penale duhet të sigurojnë koordinimin profesional dhe politikisht të papenguar në mes të organeve të zbatimit dhe sundimit të ligjit me organet tjera të sundimit të ligjit .

KIPRED propozon rekomandimet e mëposhtme për përmirësimin e përgjithshëm të hetimeve, aktakuzave dhe dënimeve të profilit të lartë të korrupsionit duke siguruar efikasitet, paanshmëri dhe drejtësi të sistemit të drejtësisë :

---

<sup>48</sup> Shih shembullin “Udhëzues i Rolit të Prokurorëve”, miratuar nga Kongresi i Tetëi Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin të të Pandehurve, Havana, Kuba, 27 gusht deri me 7 shtator 1990. Në <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RoleOfProsecutors.aspx>.

- **Duart larg nga emërimet dhe administrimin e drejtësisë:** Qeveria e ardhshme e Kosovës dhe elita politike duhet të ndalojnë ndërhyrjen e tyre në emërimin e strukturës së menaxhimit të institucioneve gjyqësore dhe policisë dhe duhet dhënë fund praktikave të tanishme të emërimeve politike, duke përfshirë dominimin rajonal të partive në pushtet. Çdo ndërhyrje e mëtejshme në proceset penale nga zyrtarët e Qeverisë dhe deputetët duhet të sanksionohen me ndryshime specifike të Kodit Penal të Kosovës.
- **Ndryshimi i strukturës menaxhuese duhet të rregullohet në përputhje me kritere të rrepta:** Çdo ndryshim në strukturën menaxhuese brenda sistemit gjyqësor dhe policisë duhet të rregullohet në pajtim me ligjin në fuqi, duke përfshirë kriteret të normës së rasteve të realizuara, meritave dhe shkallën e suksesit të kandidatëve përkatës. Për më tepër, ndryshimet e mëparshme në strukturë të menaxhmentit që janë bërë me ndërhyrje nga politika duhet të rregullohen duke krijuar rregulla të promovimit vetëm bazuar në merita dhe vlerësim të integritetit profesional.
- **Ulja e ngarkesës me raste duke harmonizuar të dhënat dhe shumimin e rasteve:** Menaxhimi i të dhënave statistikore dhe dosjeve duhet urgjentisht dhe në mënyrë profesionale të administrohet në mënyrë që të shmangët shumëzimi dhe ngarkesa me raste dhe për të shmangur çdo dështim që mund të rrezikoj donacionin nga Qeveria e Norvegjisë. Këshilli Prokurorial i Kosovës së bashku me Këshillin Gjyqësor të Kosovës duhet rregullisht të informojë publikun për progresin në trajtimin e rasteve dhe pas aktakuzës të vendos sistemin e bazës së të dhënave në dispozicion për publikun e gjerë në pajtim me ligjin e aplikueshëm (qasjen në dokumentet zyrtare).
- **Zbatimi i Planit të Veprimit në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale:** Plani i Veprimit për Rritjen e Efektivitetit të Sistemit të Prokurorisë në luftë kundër korrupsionit duhet të ndryshohet në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore që burojnë nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës. Në rast se mbetet, ajo duhet të monitorohet me kujdes nga Parlamenti, Shoqëria Civile dhe EULEX-i për të siguruar trajtimin cilësor të rasteve që do të përmbyllen deri në qershor të vitit 2014 dhe shmangja e ndikimit politik të drejtësisë selektive në këtë proces gjatë zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme në Kosovë.